



**Republika e Kosovës**  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



**Komuna e Istog**  
Opština Istok  
Municipality of Istog

01 Numër: 68/018

Data: 16.03.2018

<http://kk.rks-gov.net/istog/>

Tel: 038/200 43821

Kryetari i Komunës bazuar në nenin 5 pika d) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28/2008), lidh:

**MARRËVESHJE**  
**ME N.T.P "Balusha" ME PARTICIPIM**

**I. PALËT**

E lidhur në Istog, më: 16.03.2018, në mes të:

1. Komunës së Istogut, të cilën e përfaqëson, z.Haki Rugova, Kryetari i Komunës, në njërën anë  
dhe
2. Me N.T.P "Balusha" të cilën e përfaqëson z.Ramadan Zeqiraj nga fsh. Studenicë, Komuna e Istogut, nga ana tjetër.

**II. OBJEKT I MARRËVESHJES**

**Pika 1**

Objekti i kësaj marrëveshje është participimi me mjete financiare prej komunës së Istogut dhe "GRO AG-CHUR-CH" në koordinim me "SAVE foundation" nga Zvicrra të cilët kanë shprehur gatishmëri për të ndihmuar ndërtimin e fabrikës së djathit nga qumështi i deleve "Balusha dhe Bardhoka", e cila fabrikë do të ndërtohet në pronësi të blegtorit Ramadan Zeqiraj i cili merret me rritjen e deleve autoktone "BALUSHA".

Duke pasur parasysh mundësin e ofruar nga donatorët e Zvicrës dhe nevojën që kanë blegtorët e komunës së Istogut të kenë një fabrikë për prodhimin e djathit të deleve të racës autoktone dhe duke par gatishmërinë e "GRO AG-CHUR-CH" në koordinim me "SAVE Foundation" për të ndihmuar në shumën me vlerë prej 103,165.43 € (njëqind e tremijë e njëqind e gjashtëdhjetë e pesë euro e katërdhjetë e tre cent), atëherë:

Komuna e Istogut për realizimin e këtij projekti ndanë shumën e mjeteve financiare në vlerë prej 15,000.00 € (pesëmbëdhjetë mijë euro), nga kodi ekonomik i subvencioneve dhe transferove nga programi buxhetor i Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Hidroekonomi.

### **III. OBLIGIMET E KOMUNËS**

#### **Pika 2**

Komuna përmes kësaj marrëveshje obligohet:

- Të ndaj mjetet financiare në shumën prej 15,000.00 € (pesëmbëdhjetë mijë euro), prej programit buxhetor të Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Hidroekonomi, nga kodi ekonomik i subvencioneve dhe transfereve për ndërtimin e fabrikës së djathit sipas paramasës dhe parallogarisë së projektit;
- Komuna mjetet financiare të lartcekura do ti transferoj në xhirollogarinë e blegtorit pasi të sjellë dëshminë e pagesës së mjeteve nga "GRO AG-CHUR-CH" nga Zvicra;
- Të caktojë mbikëqyrësin për përcjelljen e realizimit të punimeve;
- Të ofrojë ndihmë përkatëse në realizim të projektit të lartcekur;
- Pas njoftimit mbi përfundimin e punimeve dhe të caktoj komisionin për pranimin e punëve.

### **IV. OBLIGIMET E BLEGTORIT**

#### **Pika 3**

Blegtori përmes kësaj marrëveshje obligohet:

- Të sjellë dëshmi për pagesën e mjeteve nga "GRO AG-CHUR-CH" nga Zvicra;
- Pas përfundimit të punimeve të caktojë një anëtar në komisionin për pranimin e punimeve;
- Të eliminojë pengesat e çfarëdo natyre qofshin ato të cilat mund të paraqiten gjatë realizimit të projektit në fjalë;
- Të caktojë një përfaqësues nga organizata Zvicerrane "GRO AG-CHUR-CH" i cili do të bashkëpunoj me kryesin e punëve dhe mbikëqyrësin e realizimit të projektit në fjalë.

### **V. OBLIGIMET E PËRBASHKËTA**

#### **Pika 4**

Palët e kësaj marrëveshje do të angazhohen që të gjitha obligimet e përcaktuara në këtë marrëveshje t'i zbatojnë më përpikëri.

Palët në marrëveshje për çdo paqartësi apo vërejte, në zbatim të obligimeve të kësaj marrëveshje komunikojnë në mes veti në formë të shkruar.

## VI. NDRYSHIMI I MARRËVESHJES

### Pika 5

Kjo marrëveshje apo një pjesë e kësaj marrëveshje mund të ndryshohet apo modifikohet nëse palët për këtë ndryshim apo modifikim pajtohen. Ndryshimi bëhet në formë të shkruar dhe është aneks i kësaj marrëveshje.

## VII. DISPOZITAT E FUNDIT

### Pika 6

Kjo marrëveshje hyn në fuqi më nënshkrimin e saj nga palët në marrëveshje.

### Pika 7

Në rast të çdo mosmarrëveshje palët do të përpiqen që të njëjtat t'i zgjedhin përmes bisedimeve të ndërsjella. Në rast të dështimit të zgjidhjeve të mosmarrëveshjeve eventuale përmes bisedimeve, atëherë kompetente për zgjidhjen e tyre është Gjykata Themelore Pejë - Dega në Istog.


Marrëveshja është hartuar në 5 kopje identike njëra me tjetrën, një kopje për "GRO AG-CHUR-CH" nga Zvicrra, një kopje për N.T.P "Balusha" të cilën e përfaqëson z.Ramadan Zeqiraj, një kopje për Drejtorinë për Bujqësi, Pylltari dhe Hidroekonomi, një kopje për Drejtorin për Buxhet dhe Financa dhe një kopje mbetet në arkivin e zyrës së Kryetarit.

**PALET NË MARRËVESHJE**  
**PËR KOMUNËN E ISTOGUT**  
**Kryetari i Komunës**  
**z. Haki RUGOVA**



nënshkruar më: 23/03/2018

**PËR N.T.P "Balusha"**  
**Blegtori**  
**z. Ramadan ZEQRIRAJ**



nënshkruar më: 23/03/2018